

**Objekti: Rehabilitim i rrjetit ujites me kanalin v-4  
gjatesia 465 ml + sekondarin 400 ml**

**SPECIFIKIME TEKNIKE TE VEÇANTA**

**SEKSIONI 1-Punime Dheu**



## SEKSIONI 1-Gërmimet

### 1.1 Qëllimi

Kontraktori do të bëjë gërmime në çdo material për seksione të ndryshme të Punimeve dhe duhet t'i hedhë materialet e gërmuara siç specifikohet, ilustruar në Skica, apo urdhëruar nga Supervizori. Specifikimet e gërmimeve ndahet në tre kategori, si vijon:

- Të përgjithshme;
- Muratura, Diga, Muratura që shërben për Mbrojtjen nga Përmytjet;
- Strukturat dhe linjat e tubacioneve.

Pikat në kapitullin 1.1 "Të përgjithshme" i referohen të gjithë llojeve të gërmimeve. Kontraktori duhet të mbrojë pjesërisht apo tërësisht zonën ku gërmimet kanë përfunduar nga dëmet që mund t'i vijnë nga vetë aktiviteti në fjalë apo nga njerëz të ndryshëm dhe në rast të ndonjë dëmi të mundshëm, zhdëmtimi duhet të mbulohet nga vetë Kontraktori.

### 1.2 Të përgjithshme

#### 1.2.1 Gërmimet sipas Profileve dhe Niveleve

Në tërësi, gërmimet për zona të ndryshme të punimeve duhet të kryhen sipas dimensioneve dhe niveleve të detajuara në skica. Dimensionet, të cilat bazohen në, apo lidhen me, nivele tabani apo skarpata duhet t'i raportohen Supervizorit para fillimit të gërmimeve.

Për qëllim të Specifikimit, termi 'nivel taban' duhet t'i referohet sipërfaqes të tabanit para fillimit të veprimeve për gërmim, por pas pastrimit nga shkurret.

#### 1.2.2 Nxjerrja e materialeve të dëmshme

Nëse në themel apo poshtë muraturës shfaqen materiale të dëmshme, Kontraktori duhet t'i heqë dhe t'i hedhë me miratimin e Supervizorit. Te të tilla materiale përfshihen rrënjë, lëndë organike, baltë, gips, rërë dhe substanca të dëmshme. Në rast se Supervizori nuk ka specifikuar apo urdhërua veprim tjetër, Kontraktori duhet të mbushë boshllëqet e krijuara në themele me beton M100 për strukturat e mëdha, dhe për struktura të vogla, si muratura dhe rrugë, me lëndë kompakte mbushëse, ndërsa për ngritjen e muraturës duhet të përdorë lëndë granulare të aprovuar më parë. Materialet që kanë rezultuar të dëmshme, pasi nxirren mbi sipërfaqe, duhen depozituar në vende të posaçme për hedhjen e mbeturinave.

Nëse Kontraktori gjen materiale të cilat për mendimin e tij mund të jenë të dëmshme për strukturën, ai duhet të informojë menjëherë Supervizorin i cili duhet të instruktojë Kontraktorin me shkrim nëse materiali në fjalë duhet trajtuar apo jo si i dëmshëm për strukturën.

#### 1.2.3 Rrëshqitjet dhe rëniet e materialeve

Kontraktori duhet të tregojë kujdesin më të madh të mundshëm dhe të marrë të gjitha masat paraprake në mënyrë që të parandalojë rrëshqitjen apo rënien e materialeve nga faqet anësore të gërmimeve apo muraturave.

Në rastet kur këto materiale rrëshqasin apo bien, Kontraktori duhet të përfundojë në mënyrën më të mirë të mundshme gërmimet dhe punimet që kanë lidhje me to dhe të kryejë modifikimet e duhura të punimeve për të përmbushur kërkesat e Supervizorit.

#### 1.2.4 Mbushja

Mbushja nënkupton material të gërmuar të përzgjedhur që vendoset në muraturë mbi nivelin origjinal të tabanit. Materiali i përzgjedhur duhet të pozicionohet në mënyrë të tillë që të përjshtojë mundësinë e përzierjes me pjesëza që tejkalojnë 150 mm madhësi, përjashtuar rastet kur kjo kërkohet apo specifikohet nga Supervizori. Materiali mbushës që vendoset përkundrejt strukturës nuk duhet të përmbajë pjesëza që tejkalojnë 50 mm madhësi, përjashtuar rastet ku kjo gjë është kërkuar dhe aprovuar nga Supervizori.

#### 1.2.5 Karierat e materialeve

Aty ku është e specifikuar në skica apo kërkuar nga Supervizori, materiali mbushës që do të përdoret për punimet duhet marrë nga zona të tjera të miratuara pas kryerjes së provave që do të vërtetojnë qëndrueshmërinë e materialeve. Pas përfundimit të gërmimeve, Kontraktori duhet të rregullojë, nivelojë dhe pastrojë zonat ku meren dherat duke plotësuar kështu kërkesat e Kontraktorit, dhe nëse i kërkohet duhet të kryejë punime të mëtejshme për të parandaluar depozitimimin dhe grumbullimin e ujrave.

#### 1.2.6 Ngjeshja e materialit mbushës dhe rimbushja

Një mbushje e ngjeshur apo rimbushja duhet të vendoset në mënyrë të tillë që materiali i aprovuar për mbushje të shqërrndahet dhe ngjeshet në shtresa pothuajse horizontale dhe me trashësi uniforme duke u anuar pak për nga jashtë dhe me një trashësi ngjeshjeje jo më shumë se 0.15 m. Lagështira e dheut duhet të kontrollohet me kujdes duke e lënë të thahet në mënyrë natyrale ose duke e spërkatur imtësisht.

Ngjeshja duhet të kryhet me rula mekanikë, tokmakë, vibratorë ose pajisje tjetër të aprovuar në mënyrë që të arrihet një masë të thatë jo më pak se **95% ± 2 OMP** duke iu referuar muraturave të kanaleve dhe materialeve të vendosura mbi nivelin taban të strukturës.

#### 1.2.7 Shkrifëzimi i tokës

Në rastet kur mbushja e muraturave, kanaleve ekzistuese dhe atyre të kullimit, duhet të ngjeshet, sipërfaqja e tabanit nën muraturë duhet të shkriftohet deri në një thellësi prej 0.20 m në mënyrë që të sigurohet lidhja e duhur mes tabanit dhe materialit mbushës. Niveli i lagështirës së sipërfaqes së shkriftuar duhet të kontrollohet me kujdes duke e lënë të thahet në mënyrë natyrale ose duke e spërkatur imtësisht. Nëse, për ndonjë arsye, procesi i ngjeshjes së materialit mbushës ndërpritet për një periudhë të pa justifikuar kohe, sipërfaqja e materialit mbushës duhet të shkriftohet para vazhdimin të procesit.

### 1.3 Muraturat, digat dhe muratura që shërbejnë për t'u mbrojtur nga përmbytjet

#### 1.3.1 Përgatitja e zonës dhe pastrimi sipërfaqësor i dheut

Kontraktori duhet të përgatisë paraprakisht zonën duke hequr, siç dhe kërkohet nga Supervizori, të gjithë llojet e materialeve që pengojnë punimet: duke hequr gjithashtu dhe pemë, bimë, trungje dhe rrënjë pemësh. Materialet që dalin gjatë përgatitjes së zonës, duke përjashtuar rastet kur Supervizori aprovon mënyra të tjera, duhen hequr duke ndjekur këto hapa:

- Materialet që rezultojnë nga rënia e pemëve ngelen në pronësinë e Punedhënesit dhe

- duhen transportuar për në sektorin e aprovuar për ruajtje;
- materialet që nuk janë të përshtatshme për t'u përdorur, nëse janë të djegshme, do të digjen, nëse jo, do të hidhen në vendin e aprovuar për hedhurina.

Kontraktori duhet të tregojë kujdes të veçantë që të mos shkaktojë përhapjen e zjarrit në pyje; para djegjes së materialeve duhet të ndërmerren masat e duhura parandaluese.

Në fazën kur materiali mbushës do të vendoset në muraturë, së pari toka duhet zhveshur nga bimësia dhe nga shtresa sipërfaqësore, të ruhet në mënyrë që të shmanget humbja dhe përkeqësimi i kushteve dhe shtresa sipërfaqësore më pas duhet të vendoset në anë dhe në majë të muraturës siç ilustron në skica dhe siç e kërkon Supervizori. Sipërfaqet e muraturës mbi të cilat do të vendoset materiali sipërfaqësor i nën-bazës së rrugës nuk duhet të mbulohen me shtresa sipërfaqësore dheu.

Tabani i muraturës, siç ilustron në skica apo siç e kërkon Supervizori, duhet të gërmohet dhe të hiqet siç tregohet në skica me një thellësi minimale prej 0.20 m.

Materialet tepricë që rezultojnë pas zhveshjes së shtresës sipërfaqësore të dheut duhet të hidhen në vendet e aprovuar.

### 1.3.2 Gërmimet dhe hedhja e materialeve

Materialet e gërmuara dhe nxjerra nga kanalet kulluese duhet të vendosen së gjati në muraturat përkatëse ose, nëse ka tepruar material tej atij që kërkohet për muraturat, përjashtoj rastet kur kjo gjë nu kërkohet, ai duhet të vendoset në ato muratura që kanë nevojë për material plotësues ngjeshës.

Teprica e materialeve të gërmuara duhet të depozitohet në vendin e përcaktuar për hedhjen e tyre.

Gjatë transportimit të materialeve mes pikave të gërmimit dhe depozitimit, Kontraktori nuk duhet në asnjë mënyrë të transportojë materiale përmes tokave të mbjella apo tokave ku punimet janë në process e sipër apo janë përfunduar nga plaë të tjera pa marrë miratimin me shkrim dhe në prani të dëshmitarëve nga pronari, fermeri apo palë të tjera të interesuara.

Kontraktori duhet të përgatisë një plan gërmimesh për çdo seksion të punimeve që do të ndërmerren në një periudhë kohe, dukë dhënë detaje për vendndodhjen dhe programin e gërmimeve në kanale dhe programin e vendosjes së materialeve në muratura. Kontraktori duhet ta dorëzojë planin e veprimeve të propozuar prej tij për çdo seksion të sistemit për të marrë Miratimin e Supervizorit.

Aty ku metoda e punës parashikohet e tillë që materialet e gërmuara të zhvendosen përgjatë gjatësisë së muraturave apo rradhitjes së rrugës, zhvendosja duhet kontrolluar me anë të vënies në zbatim të diagramave për transportimin e masiveve. Në të tilla raste, kopje të këtyre diagrameve duhet të përfshihen në planin e Kontraktorit për gërmimet që do të dorëzohet Supervizorit në përputhje me kërkesat e mësipërme.

### 1.3.3 Formacioni i muraturës

Muraturat për kanalet kulluese, mbrojtjen nga përmbytjet dhe platformat hidraulike duhet, përveç rasteve kur kjo gjë nuk specifikohet, duhet të formohen me dhera të gërmuara dhe nxjerra nga kanalizimet dhe kanalet kulluese nëse ka.

Muraturat e kanaleve kulluese, për mbrojtjen nga përmbytjet dhe rezervuarët ku pika e grumbullimit sipërfaqësor ndodhet mbi nivelin taban, nu duhet të shfaqë shenja fillesater rrjedhjesh pas mbajtjes së përzagjatur të ujit në nivel maksimal. Këto lloje muraturash dhe

muraturat mbi të cilat do të mbështeten rrugët duhen ndërtuar në mënyrat e përmendura ose ashtu siç e specifikon Supervizori. Dheart e gërmimeve duhet të shtrohen në nivele me thellësi të përafërt prej 0.3 m me ndihmën e mjeteve me zinxhirë apo me rrota, me një peshë jo më pak se 15 t.

#### **1.3.4 Tejkallim i nivelit të gërmimeve**

Nëse duhet të gërmohet ndonjë kanalizim apo kanal kullues apo nëse duhet të ndërtohet një muraturë përtej tolerancave të specifikuara, Kontraktori duhet të merret me ndërtimin e prerjeve tërthore të veçanta apo të çdo seksioni tjetër që mund të kërkojë Supervizori.

#### **1.3.5 Materialet mbushëse posaçërisht të përzgjedhura**

Aty ku materiali posaçërisht i përzgjedhur ilustruhet në Skica apo kërkohet nga Supervizori, materiali i përdorur duhet t'i japë qëndrueshmëri strukturës me nivel të ulët depërtueshmërie si dhe të marrë miratimin e Supervizorit.

### **1.4 Strukturat dhe linjat e tubacioneve**

#### **1.4.1 Tharja**

Kontraktori duhet ta mbajë zoën e gërmimeve sa më të thatë gjatë ndërtimit dhe, në rastet kur strukturat ngrihen mbi ujra sipërfaqësore të kripura apo acide kjo periudhë duhet të jetë e gjatë sa për të shmangur zhytjen e masës së betonit brenda 28 ditëve qysh prej derdhjesë saj. Mënyra e përtharjes së zonës së gërmimeve dhe e heqjes së ujit duhet t'i nënshtrohet miratimit të Supervizorit. Kontraktori duhet të sigurohet që në zonë të ketë imptiantin zëvendësues që do të shmangë në çdo moment ndërprerjen e përtharjes në vazhdimësi.

#### **1.4.2 Mënyra e Gërmimit**

Nëse kërkohet nga Supervizori, Kontraktori duhet t'ia dorëzojë metodën e gërmimeve propozuar prej tij, duke përfshirë këtu hollësitë mbi ndihmën e nevojshme gjatë gërmimeve, Supervizorit për të marrë miratimin prej tij. Për të ashtuquajtur ndihmë në gërmime si llamarinë, veshje metalike dhe traversa, nëse këto propozohen nga Kontraktori dhe miratohen nga Supervizori nuk do të bëhet pagesë e veçantë.

Gërmimet duhet të kryhen në dimensione të tilla që të lejojnë tharje të mjaftueshme, mbështetjen e duhur në faqet anësore të gërmimeve, ngritjen e armatures, derdhjen e betonit dhe materialit mbushës duke përfshirë këtu ngjeshjen dhe çdo lloj procesi tjetër ndërtimi.

#### **1.4.3 Materiali mbushës dhe rimbushja**

Material rimbushës do të thotë material i përzgjedhur që përfitohet nga gërmimet për strukturën që do të ndërtohet dhe që vendoset nën nivelin fillestar të tabanit. Përzgjedhja do të bëhet njëlloj si për materialin mbushës që specifikohet në Pikat 1.2.5 dhe 1.2.7. Aty ku e kërkon Supervizori, duhet ngjeshur veçanërisht materiali mbushës mbi nivelin fillestar të tabanit të strukturës apo afër saj.

#### **1.4.4 Tejkallim i nivelit të gërmimeve**

Çdo gërmim shtesë për struktura që tejkalojnë limitet e specifikuara apo të kërkuara, duhet të mbushet nga Kontraktori, i cili me shpenzimet e veta, përdor beton të të njëjtës klasë me

betonin e derdhur në themele apo me materiale mbështetëse zhavorri apo me material mbushës posaçërisht të ngjeshur, sipas kërkesave të Supervizorit.

#### **1.4.5 Rregullimi manual në nivelin e formacionit**

Aty ku nivelit të formacionit të çdo gërmimi do t'i hidhet beton apo material mbështeto-  
mbushës me distancë 0.15 thellësi të gërmimeve duhet të rregullohet në mënyrë manuale,  
ose duke ndjekur metoda të ngjashme siç aprovet apo kërkohet nga Supervizori, pas  
tharjes dhe menjëherë para derdhjes së betonit apo materialit mbështeto-  
mbushës.

#### **1.4.6 Mbrojtja e punimeve**

Propozimet e Kontraktorit për të mbrojtur punimet sipas Kontratës nga dëmtime që mund të  
vijjnë nga përmytjet ose përndryshe gjatë procesit të punimeve kur ndërtohen struktura që  
lidhen me të, duhet t'u dorëzohen Supervizorit, por një veprim i tillë nuk do të thotë që  
Kontraktori nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për çdo dëmtim që mund të vijë më pas.

#### **1.4.7 Provat në nivelin e formacionit**

Pas arritjes së nivelit për rregullim manual të specifikuar në Pikën 1.4.7, Supervizori mund të  
kërkojë vizita të tjera në terren dhe prova të tjera siç është e specifikuar, në mënyrë që të  
përcaktohet natyra dhe ngjeshja e tokës.

